



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK BERAT

V E N D I M

NR 68 Datë 17/08 2025

“MBI MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT TË BASHKISË BERAT”

Këshilli Bashkiak Berat në mbledhjen e datës 12/09/2025 ,në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 8, 9, 54, 64, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I :

1.Miratimin e Planit të Integritetit për Bashkinë Berat, bashkëlidhur këtij vendimi, i përgatitur nga grupi punës të ngritur me urdhër . Nr.510, datë 14.07.2025.

2.Personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit do të caktohet: Arisa Toska, Sekretare e Përgjithshme. Personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit ka për detyrë të monitorojë zbatimin e Planit të integritetit, vecanërisht planin e veprimit për menaxhimin e riskut të integritetit dhe të bëjë sugjerimet e nevojshme për përmirësimin e tij.Të gjithë punonjësit e Bashkisë Berat informojnë personin përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit, mbi gjendjen integritetit të bashkisë, për veprime apo ngjarje që mund të ndodhin dhe mund të çojnë në cënimin e integritetit të bashkisë. Punonjësit e Bashkisë duhet me kërkesë të personit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit të dorëzojnë të dhëna dhe informata të një rëndësie të nevojshme për zbatimin e planit të integritetit, të cilat nuk janë në kundërshtim me rregulloret në fuqi. Së paku një herë në vit dhe më shpesh nëse është e nevojshme, personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit është i detyruar të paraqesë para Këshillit Bashkiak,një raport mbi zbatimin e planit të integritetit.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

EVISA ÇELA

Vendimi u miratua me 20

 vota kundër

 vota abstenim

